



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo lokalne samouprave
Ministry of Local Government

Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar - Dhjetor 2020



Prishtinë, 2021

Përmbajtja

Shkurtesat	3
Hyrje.....	4
Përmbledhje Ekzekutive.....	5
1. KRITERET POLITIKE	6
1.1 Administrata Publike.....	6
1.2 Avokati i popullit	7
1.3 Shoqëria civile	7
1.4 Lufta kundër korrupsionit dhe kundër terrorizmit	7
1.5 Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore	8
2. KRITERET EKONOMIKE	9
2.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut.....	9
2.2 Tatimet.....	9
2.3 Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë	10
3 STANDARDET EVROPIANE.....	10
3.1 Bujqësia dhe zhvillimi rurale	10
3.2 Energjia	11
3.3 Gjyqësori dhe të drejtat themelore	12
3.4 Mbrojtja e minoriteteve.....	14
3.5 Drejtësia, liria dhe siguria,	14
3.6 Menaxhimi i kufirit dhe migracioni.....	15
3.7 Arsimi dhe kultura.....	16
3.8 Mjedisi.....	16
3.9 Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik.....	17
4 VEPRIMET E NDËRMARRA NGA KOMUNAT ME RASTIN E COVID -19	18
REKOMANDIMET.....	19

Shkurtesat

BE	Bashkimi Evropian
EVS	Ekipet Vepruese për Siguri
KE	Komisioni Evropian
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Këshillat Lokale për Siguri Publike
MPL	Ministria e Pushtetit Lokal
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizata joqeveritare
PKZMSA	Programi Kombëtar i Zbatimit të MSA-së

Hyrje

Ky raport paraqet implementimin e obligimeve të komunave, që burojnë nga Agjenda Evropiane gjatë vitit 2020. Duke pasur parasysh se Programi Kombëtar i Zbatimit të MSA është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha Institucionet e Kosovës, Ministria e Pushtetit Lokal është e përkushtuar në përmbushjen e obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve, MPL ka zhvilluar disa mënyra të adresimit të çështjeve në nivel lokal për të shtyrë para agjendën evropiane, duke veçuar: koordinimin e procesit të planifikimit, hartimin e planit të përgjithshme për obligimet e komunave në procesin e integritit evropian, hartimin e planeve individuale të komunave si dhe hartimin e raportit të përmbushjes së obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane për dy periudha brenda vitit Janar-Qershor dhe Korrik -Dhjetor.

Raporti ka rol të rëndësishëm dhe domethënës mbi zhvillimin e aktiviteteve të nivelit lokal në fushën e integritit evropian, marrë parasysh përgjegjësinë që kanë komunat në raport me qytetarët dhe institucionet publike. Qëllimi i këtij raporti është prezantimi dhe ofrimi i të dhënave të komunave për qytetarët, institucionet vendore dhe ndërkombëtare, organizatat joqeveritare si dhe çdo grupi tjetër të interesit, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Bashkimi Evropian.


Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport paraqet të arriturat vjetore të komunave në përbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane e vendit. Të dhënat e këtij raporti përfshijnë raportimet e 38 komunave të Republikës së Kosovës për periudhën Janar – Dhjetor 2020.

Raporti është i bazuar në 53 veprime/masa dhe 168 pyetje/indikator që bien në përgjegjësi dhe kompetencë të komunave, për të cilat Ministria e Pushtetit Lokal ka kërkuar veprime konkrete nga komunat. MPL në komuna ka adresuar të gjitha çështjet që burojnë nga PKZMSA, nga konkluzionet e nënkomiteteve sektoriale si dhe nga sfidat e raportit të KE-së për Kosovën.

Sa i përket strukturës së gjithmbarshme, raporti përqendrohet në fushat kryesore të aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me kriteret politike, kriteret ekonomike, standardet evropiane si dhe raporti pasqyron gjendjen reale të arriturave të komunave, por njëkohësisht edhe të sfidave për vitet në vijim. Duke pasur parasysh zhvillimin e pandemisë COVID-19 dhe kontributin e komunave në këtë fazë, raporti përfshin edhe kapitullin e pandemisë COVID-19.

Në kuadër të **kritereve politike** prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat: administratë publike, avokati i popullit, shoqëria civile, lufta kundër terrorizmit, mbrojtja dhe trashëgimia kulturore. Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përbushin përafërsisht **57%** të aktiviteteve. Në kuadër të **kritereve ekonomike** prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat: ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut, tatimet, ndërmarrjet dhe politikat e industrisë dhe tregu i brendshëm. Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përbushin përafërsisht **65%** të aktiviteteve. Në kuadër të **standardeve evropiane**, prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat: bujqësi dhe zhvillimi rural, energjia, gjyqësori dhe të drejtat themelore, mbrojtja e minoriteteve, drejtësia, liria dhe siguria, menaxhimi i kufirit dhe migracioni, arsimi dhe kultura, mjedisi dhe mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik. Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përbushin përafërsisht **57%** të aktiviteteve.



Diagrami 1. Përbushja e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane, Janar-Dhjetor 2020

Në përgjithësi komunat kanë arritur t'i përbushin 60% të obligimeve të komunave të përcaktuara me planin gjithëpërfshirës për vitin 2020, që bien nën përgjegjësinë e implementimit të qeverisjes lokale. Duke pasur parasysh gjendjen e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe vendosjen e komunave në karantinë, gjatë këtij viti ka pasur pezullime të përkohshme të zhvillimit të aktiviteteve, andaj për dallim nga viti i kaluar është vërejtur ulje e dukshme e trendit të të arriturave në përbushjen e obligimeve nga ana e komunave.

Në kuadër të kapitullit të pandemisë COVID-19 prezantohet menaxhimi i gjendjes së COVID-19 në nivel lokal duke përfshirë masat të cilat janë ndërmarrë nga komunat konform udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, normuar me vendime konkrete të qeverisë.

1. KRITERET POLITIKE

1.1 Administrata Publike

Një nga fushat kryesore që bënë pjesë në kuadër të kritereve politike është funksionimi i administratës publike lokale. Gjatë vitit 2020, komunat e Republikës së Kosovës kanë ndërmarr aktivitete për sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për administratën e pushtetit lokal, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarë, rritjen e efikasitetit dhe transparencës, si dhe ndërtimin e mekanizmave më efikas të llogaridhënies në raport me qytetarët.

Në kuadër të masave për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, 32 komuna kanë hartuar programin e trajnimeve ndërsa në 6 komuna (*Obiliq, Ranillug, Prishtinë, Podujevë, Shtërpçë dhe Mitrovicë e Veriut*) nuk është hartuar programi i trajnimeve për vitin 2020. Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kornizës së politikave në fushën e administratës, pasqyra e të dhënave tregon se një numër i konsiderueshëm i komunave kanë hartuar Strategjinë për Komunikim me Publikun ku nga 38 komuna raportuese janë 14 komuna të cilat kanë hartuar këtë strategji ndërsa 24 komuna (*Obiliq, Shtime, Ferizaj, Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Kllokot, Kamenicë, Prizren, Viti, Mitrovicë Jugore, Prishtinë, Dragash, Glllogoc, Mitrovicë Veriore, Kaçanik, Leposaviq, Fushë Kosovë, Gjiilan, Lipjan, Junik dhe Shtërpçë*) ende nuk e kanë hartuar.



Diagrami 2: Programit i trajnimeve dhe Strategjia për Komunikim me Publikun

Për mundësimin gjithëpërfshirës të qytetarëve në procesin e hartimit të politikave përmes konsultimit publik, janë 34 komuna të cilat kanë ndërmarrë veprime konkrete që qytetarët të përfshihen në konsultime publike, përmes: *thirrjeve publike, shpërndarjes së fletushkave, fushatave sensibilizuese, zgjerimit të rrjetit të informimit publik, hartimit të planit për pjesëmarrjen e qytetarëve në konsultime publike* etj, ndërsa 4 komuna (*Istog, Shtime, Mamushë, Fushë Kosovë*) nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim. Disa nga sfidat e paraqitura në 25 komuna, në zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore janë: *bashkëpunimin i dobët në mes të nivelit qendror dhe nivelit lokal në hartimin e këtyre politikave, mungesa e konsultimeve paraprake i cili është obligim ligjor, mungesa e stafit profesional, mungesa e pjesëmarrjes në trajnime me qëllim të aftësisë profesionale, mungesa e informimit të qytetarëve, barrierat gjubësore* etj. Në anën tjetër, janë 13 komuna (*Prizren, Prishtinë, Partesh, Podujevë, Kamenicë, Malishevë, Gjiilan, Gjakovë, Mamushë, Kaçanik, Deçan, Rabovec, dhe Skenderaj*) të cilat nuk hasin në ndonjë vështirësi.

Në katër komunat e veriut të Kosovës, janë themeluar drejtoritë dhe janë emëruar drejtorët e drejtorive komunale. Në anën tjetër, vetëm 1 komunë (*Zubin Potok*) ka themeluar qendrat për shërbim të qytetarëve, deri sa funksionalizimi i sistemit të intranetit në kuadër të shërbimeve administrative është ngritur në 3 komuna (*Zubin Potok, Leposaviq dhe Mitrovicë Veriore*).

Përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në 32 komuna janë 1191 të punësuar nga komuniteti jo shumicë në përjashtim të 4 komunave (*Hani Elezi, Kaçanik, Junik, Glllogoc*) të cilat kanë raportuar që nuk kanë të punësuar nga komuniteti jo shumicë si dhe 2 komuna (*Obiliq dhe Mitrovicë e Veriut*) nuk ka ofruar të dhëna.

1.2 Avokati i popullit

Rritja e përgjegjësisë së qeverisjes lokale karshi kërkesave/rekomandimeve nga Avokati i Popullit për ndërmarrjen e veprimeve konkrete për qeverisjen lokale ka qenë një ndër prioritetet e vitit 2020, lidhur me këtë nga 38 komuna vetëm 13 komuna (*Gjakovë, Novobërdë, Vushtrri, Malishevë, Gjiilan, Fushë Kosovë, Prishtinë, Prizren, Viti, Kamenicë, Glllogoc, Junik dhe Mitrovicë Veriore*) kanë pranuar 39 kërkesa/rekomandime prej tyre 19 kërkesa janë kthyer pozitive dhe 20 kërkesa gjenden në proces të shqyrtimit.

1.3 Shoqëria civile


Komunat kanë ofruar bashkëpunim edhe me organizatat e shoqërisë civile. Një rrjet i gjerë i organizatave jo-qeveritare që veprojnë në vend përcjellin dhe angazhohen në projekte të cilat synojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve. Në 30 komuna janë ndarë buxhet me shumë prej 17,799,274.43 euro, ndërsa në 8 komuna (*Mamushë, Ferizaj, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Klllokot, Deçan dhe Shtërpçë*) nuk është ndarë buxhet, me këtë mbështetje financiare janë përkrahur 1138 projekte të OJQ-ve. Gjithashtu, transparenca e publikimit të OJQ-ve përfituese, përkatësisht publikimi i mjeteve, kritereve dhe OJQ-të përfituese në ueb faqet e komunave është bërë në 24 komuna të cilat kanë përkrahur organizatat e shoqërisë civile, ndërsa 6 komuna tjera: *Obiliq, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë e Veriut, Graçanicë dhe Kamenicë* nuk i kanë publikuar këto të dhëna.

1.4 Lufta kundër korrupsionit dhe kundër terrorizmit

Më qëllim të luftimit të korrupsionit, komunat në vazhdimësi në rast të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal kanë deklaruar rastet e konfliktit të interesit. Gjatë vitit 2020, në 35 komuna nuk ka pasur asnjë rast të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal kurse në 3 komuna (*Hani Elezit, Graçanicë dhe Rabovec*) kanë qenë 5 raste. Sa i përket anëtarëve të kuvendit, që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në

kuvend të komunës janë 3 komuna (*Lipjan, Malishevë dhe Kaçanik*) të cilat kanë paraqitur 7 raste të konfliktit të interesit.

Për promovimin e integritetit, komunat kanë vazhduar në hartimin e planeve për integritet, ku në 18 komuna është hartuar Plani Lokal për Integritet ndërsa në 20 komuna (*Obiliq, Ferizaj, Shtime, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Kllokot, Kamenicë, Zveçan, Hani Elezit, Prizren, Mitrovicë Jugore, Deçan, Dragash, Klinë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, dhe Shtërpçë*) nuk është hartuar Plani Lokal për Integritet. Pjesa më e madhe e komunave nuk e kanë të emëruar zyrtarin që raporton për Planin Lokal të Integritetit, nga 38 komuna raportuese vetëm 17 komuna kanë emëruar zyrtarin përkatës, ndërsa 21 komuna (*Malishevë, Subarekë, Novobërdë, Obiliq, Ranillug, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Graçanicë, Junik, Prizren, Viti, Podujevë, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Fushë Kosovë, Kamenicë dhe Prishtinë*) nuk e kanë emëruar zyrtarin ende.



Diagrami 3: Plani Lokal për Integritet dhe zyrtari i emëruar për planin e integritetit

Një numër i ulët i komunave kanë vazhduar në mbështetjen dhe parandalimin e luftës kundër terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, ku vetëm 13 komuna kanë ndërmarrë veprime konkrete për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shprijë në ekstremizëm të dhunshëm si: *fushata vetëdijësuese me qytetarët, aktivitete në terren, diskutime gjatë takimeve të rregullta me anëtarët e KKJB-së* etj ndërsa 25 komuna (*Prizren, Prishtinë, Viti, Podujevë, Istog, Kllokot, Zveçan, Klinë, Rahovec, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Junik, Fushë Kosovë, Lipjan, Malishevë, Gjakovë, Novobërdë, Mamushë, Vushtrri, Obiliq, Ranillug dhe Zubin Potok*) nuk janë ndërmarrë veprime. Në 38 komuna nuk ka pasur asnjë rast të paraqitur në Këshillat Komunal të Sigurisë në Bashkësi lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.

1.5 Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore

Në fushën e trashëgimisë kulturore sfidë e komunave vazhdon ende të mbetet hartimi i planeve komunale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, pasi që sipas të dhënave të komunave janë vetëm 5 komuna (*Lipjan, Prizren, Rahovec, Skenderaj dhe Kaçanik*) të cilat kanë hartuar këtë plan. Në kuadër të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë në 27 komuna janë ndërmarrë këto veprime: *fushata vetëdijësuese; shpërndarja e broshurave të ndryshme dhe njoftime; përgatitja e hartave dhe broshurave të cilat janë në numër të konsiderueshëm për qytetarët dhe vizitorët; investimet (restaurimet) në asetet e trashëgimisë kulturore; kampanja sensibilizuese; bashkëpunim me Qendrën Regionale për Trashëgimi Kulturor; organizime të vizitave në muze nga nxënës të shkollave të mesme*

dhe studentë; shenjëzimi i zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore, etj, ndërsa 11 komuna (Novobërdë, Mamushë, Klinë, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Mitrovicë Jugore, Podujevë, Kllokot, Hani të Elezit, Ranillug dhe Zubin Potok) nuk kanë ndërmarrë asnjë aktivitet.

Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 3 raste të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura në 2 komuna (Istog dhe Rahovec), për të cilat janë ndërmarrë masat përkatëse procedurale. Po ashtu, në 15 komuna janë vendosur pajisjet për monitorimin e sigurisë të objekteve të trashëgimisë kulturore/kishave ortodokse. Në 8 komuna (Gjilan, Shtime Subarekë, Novobërdë, Vushtrri, Obiliq, Ferizaj, Istog) janë siguruar pjesërisht, si dhe në 15 komuna (Kaçanik, Pejë, Rahovec, Glogoc, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Malishevë, Partesh, Prishtinë, Kamenicë, Kllokot, Hani i Elezit, Ranillug, Mitrovica) nuk janë siguruar pajisjet e monitorimit të sigurisë.

Për zbatimin e Ligjit për Hoçen e madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit janë ndërmarr veprime nga komunat përkatëse, ku janë shqiptuar dënime mandatorë dhe janë caktuar inspektorët komunal për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit të Prizrenit. Gjithashtu, ka vazhduar të jetë funksional Këshilli për Fshatin Hoçë e Madhe për të cilin janë alokuar fonde në vlerë prej **24904.00 €**. Sa i përket rehabilitimit të shtratit të lumit Lumbardhi, komuna e Prizrenit gjendet në proces të rehabilitimit.

Në Komunën e Fushë Kosovës është duke u bërë studimi i fizibilitetit për themelimin e Muzeut të Natyrës në bashkëpunim me Ministrin e Kulturës, Rinis dhe Sportit.

2. KRITERET EKONOMIKE

2.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut

Për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët është paraparë krijimi i qendrave për regjistrimin e bizneseve (one stop shop-et) qendra të cilat lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për biznese përfshirë regjistrimet e tyre. Në 31 komuna janë funksionale, mbetet edhe në 7 komuna (Mamushë, Zubin Potok, Kllokot, Zveçan, Prishtinë, Partesh, Junik) funksionalizimi i tyre. Për mbështetjen e bizneseve janë 15 komuna të cilat kanë ofruar mbështetje financiare me vlerë prej 1,369,069.08 euro, ndërsa 23 komuna (Lipjan, Malishevë, Gjilan, Subarekë, Novobërdë, Mamushë, Obiliq, Zubin Potok, Deçan, Dragash, Klinë, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Junik, Viti, Partesh, Istog, Kllokot, Zveçan, Hani i Elezit, Ranillug) nuk kanë ndarë mjete buxhetore.

Numri i inspektorëve të tregut në 29 komuna është 63, ndërsa janë 9 komuna (Novobërdë, Zubin Potok, Mamushë, Prishtinë, Zveçan, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë Veriore dhe Shtime) të cilat ende nuk kanë inspektor të tregut. Niveli i koordinimit në mes të inspektoratit të tregut lokal me atë qendrorë është i vazhdueshëm me anë të takimeve të rregullta. Sa i përket dëgjimeve publike për planifikimin e buxhetit në 31 komuna janë mbajtur 162 dëgjime publike, kurse në 7 komuna (Novobërdë, Zubin Potok, Obiliq, Gjilan, Prishtinë, Kllokot, Kamenicë) nuk është mbajtur asnjë dëgjim publik.

2.2 Tatimet

Luftimi dhe parandalimi i ekonomisë jo formale mbetet njëri nga synimet dhe prioritetet e komunave, në 29 komuna janë ndërmarr veprime si: *vërejtje me gojë dhe me shkrim; inspektime mbi posedimin certifikatave të regjistrimit të bizneseve dhe lëshimin e faturave-kupon fiskal; inspektime në subjekte të cilat janë gjendur duke ushtruar veprimtari pa qenë të*

regjistruara (ekonomi në të zezë) ndaj të cilëve janë marrë masat e përcaktuara me ligj etj, ndërsa 9 komuna (Zubin Potok, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Zveçan, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Ranillug) nuk kanë ndërmarr masa.

Komunat po ashtu, janë koncentruar edhe në përmirësimin e menaxhimit të financave publike. Zbatimi i rekomandimeve të auditorit ndikon në përmirësimin e menaxhimit të financave publike për një performancë sa më të mirë dhe shërbime më të mira ndaj qytetarëve andaj gjatë vitit 2020, nga 38 komuna raportuese 33 prej tyre kanë pranuar 455 rekomandime nga Auditori i Përgjithshëm. Prej tyre të adresuar janë 256 rekomandime, të pa adresuara mbesin 112 rekomandime dhe të tjerat gjenden në proces. Nga këto rekomandime, janë pranuar 119 rekomandime financiare dhe 37 rekomandime të performancës. Për përmirësimin e menaxhimit të financave lokale 32 komuna kanë ndërmarr veprime si: *formimi i grupit punues për zbatimin e rekomandimeve të auditorit, hartimi i planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve të auditorit, përgatitja e listës së rreziqeve dhe raportit vetëvlerësues, rritje të llogaridhënies etj.*

Njësia e Auditimit të Brendshëm është e funksionalizuar në 28 komuna, ndërsa janë 11 komuna (*Mamushë, Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Partesh, Zveçan, Hani i Elezit, Obiliq, Podujevë, Klllokot dhe Fushë Kosovë*) të cilat ende nuk e kanë funksionale këtë njësi, komunat të cilat kanë të funksionalizuara këto njësi kanë respektuar rregullat dhe procedurat e përcaktuara në proceset e auditimit. Sa i përket planifikimit të pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal, janë 24 komuna të cilat kanë publikuar regjistrin e pronës komunale, ndërsa në 14 komuna (*Gjilan, Mamushë, Zubin Potok, Deçan, Klinë, Kaçanik, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Junik, Prishtinë, Podujevë, Istog, Zveçan dhe Hani i Elezit*) nuk është bërë publikimi i regjistrit.

2.3 Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë

Në 12 komuna është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike, ndërsa në 21 komuna (*Ferizaj, Gjakovë, Novobërdë, Mamushë, Obiliq, Ranillug, Zubin Potok, Deçan, Klinë, Kaçanik, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Junik, Prishtinë, Podujevë, Istog, Zveçan, Hani i Elezit, Klllokot, Fushë Kosovë dhe Kamenicë*) nuk është bërë ende funksionalizimi, si dhe 5 komuna (*Lipjan, Malishevë, Gjilan, Vushtrri dhe Prizren*) gjenden në proces të funksionalizimit të këtyre zonave.

3 STANDARDET EVROPIANE

3.1 Bujqësia dhe zhvillimi rurale


Komponentë kryesore e zhvillimit ekonomik lokal mbetet sektori i bujqësisë, përkatësisht zbatimi i duhur dhe efektiv i politikave të cilat janë thelbësore për funksionimin e politikave të përbashkëta bujqësore evropiane. Sfidë e theksuar mbetet hartimi i dokumenteve për rregullimin e mëtejshëm të tokave bujqësore pasi që vetëm 6 komuna (*Lipjan, Prishtinë, Podujevë, Kamenicë, Glllogoc dhe Junik*) kanë hartuar Plan Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ndërsa Plani për Menaxhimin e Tokave Rurale është i hartuar vetëm në 2 komuna (*Lipjan dhe Shtime*).

Gjatë vitit 2020, në 21 komuna janë parashtruar 240 kërkesa për ndërrimin e destinimit të tokës, ndërsa në 17 komuna (*Gjakovë, Gjilan, Lipjan, Ranillug, Zubin Potok, Mamushë, Partesh, Zveçan, Kamenicë, Mitrovicë, Dragash, Klinë, Leposaviq, Skenderaj, Shtërpçë, Junik dhe Mitrovicë Veriore*) nuk ka pasur kërkesa të parashtruara. Krahas kësaj lidhur me këto kërkesa janë nxjerr 226 vendime nga 18 komuna, ndërsa në 20 komuna (*Gjakovë, Gjilan, Obiliq, Ranillug,*

Zubin Potok, Subarekë, Mamushë, Partesh, Zveçan, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Glllogoc, Dragash, Klinë, Leposaviq, Rahovec, Skenderaj, Shtërpçë, Junik dhe Mitrovicë Veriore) nuk ka pasur vendime të miratuara.

Lidhur me konsolidimin e mëtejshëm të qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural në 33 komuna janë të funksionalizuara qendrat informative, ndërsa në 5 komuna (*Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Podujevë, Klllokot dhe Zubin Potok*) ende nuk janë funksionalizuar. Janë 29 komuna të cilat kanë ofruar mbështetje për 6952 fermerë për kultivimin e bujqësisë në sektorë të: *blegtorisë, pemëtarisë, drithërave, perimtarisë, përfitues të kultivimit me Bimë Mjekësorë dhe Aromatike (BMA)* etj, ndërsa 9 komuna (*Mamushë, Ranillug, Zubin Potok, Deçan, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Junik dhe Klllokot*) gjatë këtij viti nuk kanë ofruar mbështetje për fermerët.

Për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe promovimin e rëndësisë së tokave bujqësore, në 10 komuna janë mbajtur fushata vetëdijesuse, ndërsa në 29 komuna (*Lipjan, Ferizaj, Malishevë, Shtime, Novobërdë, Mamushë, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Prishtinë, Viti, Partesh, Istog, Hani i Elezit, Kamenicë, Gjakovë, Obiliq, Ranillug, Zubin Potok, Podujevë dhe Klllokot*) nuk është mbajtur asnjë fushat.



Janë 16 komuna të cilat kanë inspektorë të bujqësisë, derisa janë 22 komuna (*Vushtrri, Obiliq, Malishevë, Gjakovë, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Klllokot, Fushë Kosovë, Kamenicë, Zveçan, Mitrovicë Jugore, Partesh, Dragash, Kaçanik, Glllogoc, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Pejë dhe Gjilan*) të cilat ende nuk kanë inspektorë të bujqësisë.

Diagrami 4: Inspektorët e bujqësisë


Numri i inspektimeve bujqësore në 14 komuna është 4229, kurse 24 komuna (*Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Malishevë, Mamushë, Gjilan, Istog, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Podujevë, Klllokot, Viti, Partesh, Zveçan, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Dragash, Kaçanik, Leposaviq, Pejë, Shtërpçë dhe Mitrovicë Veriore*) nuk kanë pasur inspektime. Lidhur me këto inspektime në 8 komuna (*Gjakovë, Lipjan, Shtime, Vushtrri, Prishtinë, Prizren, Glllogoc dhe Rahovec*) numri i fletëparaqitjeve të parashtruara është 218.

3.2 Energjia

Komunat në vazhdimësi kanë bërë zhvillime të mëtejshme në politikat e fushës së efijencës së energjisë me qëllim të zbatimit të obligimeve të dala nga MSA, progres i cili është specifikuar edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën të vitit 2019. Planin për Efijencë të Energjisë e kanë hartuar 32 komuna, ndërsa vetëm 6 komuna (*Vushtrri, Malishevë, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Zveçan dhe Leposaviq*) nuk e kanë të hartuar ende këtë plan. Me qëllim të zbatimit të këtij plani, komunat kanë zhvilluar një numër të madhë të projekteve.

3.3 Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi obligon komunat të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi. Deri më tani 32 komuna kanë emëruar zyrtarin për mbrojtjen nga diskriminimi, ndërsa 6 komuna (*Mamushë, Deçan, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Podujevë, Istog*) ende nuk e kanë të emëruar zyrtarin përkatës. Sa i përket bashkëpunimit me nivelin qendror, 23 komuna kanë raportuar se kanë pasur bashkëpunim dhe përkrahje të vazhdueshme nga niveli qendror, ndërsa 16 komuna të tjera (*Mamushë, Obiliq, Ranillug, Zubin Potok, Deçan, Kaçanik, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Zveçan, Malishevë, Podujevë, dhe Istog*) kërkojnë forcimin e bashkëpunimit në mes të dy niveleve.



Diagrami 5: Mekanizmat lokal për zbatimin e ligjit kundër diskriminimit

Komunat kanë vazhduar aktivitetet e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ku në 21 komuna janë zhvilluar aktivitete për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut si: *ligjërata nëpër shkolla; sesione informuese dhe këshillëdbënëse; fushata ndërgjegjësuese* etj, për të cilat aktivitete është ndarë edhe buxhet nga komunat, ndërsa në 17 komuna (*Lipjan, Vushtrri, Mamushë, Zubin Potok, Deçan, Klinë, Rahovec, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Viti, Partesh, Kllokot, Zveçan, Fushë Kosovë dhe Istog*) nuk ka pasur aktivitete. Një tjetër e gjetur nga raporti i KE-së për Kosovën ka qenë edhe hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër dhunës në familje, e cila strategji është hartuar vetëm në 8 komuna (*Lipjan, Gjakovë, Istog, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Dragash dhe Skenderaj*). Në 23 komuna janë paraqitur 1212 raste të dhunës, kurse në 15 komuna (*Malishevë, Shtime, Novobërdë, Mamushë, Ranillug, Deçan, Dragash, Kaçanik, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Graçanicë, Podujevë, Partesh, Lipjan dhe Istog*) nuk ka pasur raste të paraqitura të dhunës. Komunat kanë raportuar që ndaj rasteve të paraqitura kanë ndërmarr veprime dhe kanë ofruar mbështetje. Ndërsa për rritjen e vetëdijesimit të publikut për dhunën në familje janë 29 komuna të cilat kanë ndërmarr masa/veprime ndaj viktimave të dhunës në familje konform ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje si: *vetëdijesimi i qytetareve mbi pasojat e dhunës në familje, këshillime sociale dhe fushata vetëdijësuese*. Në 9 komuna (*Ferizaj, Mamushë, Klinë, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Graçanicë, Istog, Kllokot dhe Ranillug*) nuk është ndërmarr asnjë masë.

Sa i përket themelimit të këshillit komunal për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në baza gjinore, në 20 komuna është themeluar ky këshill, ndërsa në 18 komuna (*Deçan, Klinë, Kaçanik, Rahovec, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Junik, Kllokot, Fushë Kosovë, Kamenicë, Ferizaj, Novobërdë, Vushtrri, Gjakovë, Mamushë, Ranillug dhe Zubin Potok*) nuk janë themeluar ende.

Gjatë kësaj periudhe janë bërë përpjekje të vazhdueshme nga komunat për të përkrahur zbatimin e politikave gjinore, ku në 38 komuna numri i femrave në pozita menaxheriale është 1859. Krahas tyre, në administratën publike lokale duke përfshirë edhe kuvendin e komunës në 38 komuna, janë të përfshira 3669 femra.

Lidhur me zbatimin e të drejtave pronësore të grave në 30 komuna kanë ndërmarr veprime me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave: *janë zhvilluar aktivitete me gratë e viseve rurale, lirim i grave nga taksat komunale për regjistrimin e pronës së përbashkët, takime me grupe të grave dhe punëtori si dhe janë shpërndarë postera dhe fletushka*, në 8 komuna (*Gjakovë, Zubin Potok, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Istog, Zveçan, dhe Hani i Elezit*) nuk janë ndërmarr veprime.

Sfidë tjetër e identifikuar nga raporti i Komisionit Evropian për nivelin lokal të qeverisjes është edhe zbatimi i ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, gjë për të cilat një numër i konsiderueshëm i komunave kanë shfaqur sfidat dhe vështirësitë e tyre në zbatimin e këtij ligji si: *mungesa e mjeteve financiare, mungesa e stafit profesional si dhe numri i ulët i dëgjimeve publike*. Në 18 komuna janë caktuar zyrtarët përkatës për mbrojtjen e fëmijëve, ndërsa në 20 komuna (*Malishevë, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Rabovec, Glllogoc, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Novobërdë, Prizren, Istog, Zveçan, Fushë Kosovë, Obiliq, Zubin Potok, Podujevë dhe Klllokot*) ende nuk janë caktuar zyrtarët përkatës. Për rritjen e vetëdijesimit mbi këtë ligj në 13 komuna janë organizuar fushata vetëdijesuese edukuese ndërsa 23 komuna (*Lipjan, Ferizaj, Malishevë, Subarekë, Shtime, Novobërdë, Ranillug, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Junik, Rabovec, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Viti, Fushë Kosovë, Obiliq, Zubin Potok, Podujevë, Istog, Klllokot dhe Zveçan*) nuk kanë zhvilluar asnjë fushatë. Janë 7 komuna (*Lipjan, Mamushë, Kaçanik, Pejë, Malishevë, Gjilan dhe Mitrovicë Veriore*) të cilat kanë ndarë mjete financiare për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Për fuqizimin e nivelit lokal në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 7 komuna (*Lipjan, Ferizaj, Novobërdë, Subarekë, Partesh, Mitrovicë dhe Pejë*) kanë hapur dhe funksionalizuar strehimoret për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Gjatë vitit 2020, në 9 komuna janë paraqitur 115 raste të strehimit dhe kompensimit të viktimave të trafikimit për të cilat raste është siguruar ndihmë nga komunat. Për mbështetjen e këtyre strehimoreve janë alokuar mjete nga komunat. Ndërsa sa i përket miratimit të Planit tre-vjeçar për strehim social në 13 komuna është hartuar derisa janë 25 komuna (*Malishevë, Novobërdë, Vushtrri, Mamushë, Obiliq, Dragash, Klinë, Kaçanik, Junik, Rabovec, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Prishtinë, Viti, Mitrovicë Jugore, Istog, Klllokot, Zveçan, Kamenicë, Hani i Elezit, Ranillug, Zubin Potok dhe Partesh*) të cilat ende nuk kanë hartuar këtë plan.

Funksionalizimi i Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuar është arritë në 22 komuna, ndërsa në 16 komuna (*Novobërdë, Mamushë, Obiliq, Deçan, Dragash, Klinë, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Podujevë, Partesh, Istog, Klllokot, Kamenicë dhe Ranillug*) nuk është funksionalizuar. Sa i përket ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, vetëm në 5 regjione (*Ferizaj, Gjilan, Gjakovë, Pejë, Prizren*) janë funksionale zyrtar rajonale për ndihmë juridike falas. Ndërsa zyrtar mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike, janë themeluar në 12 komuna, si dhe në 26 komuna (*Gjilan, Shtime, Mamushë, Obiliq, Lipjan, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Junik, Rabovec, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Prishtinë, Klllokot, Zveçan, Fushë Kosovë, Hani i Elezit, Viti, Podujevë, Partesh, Kamenicë, Novobërdë, Vushtrri, Ranillug dhe Zubin Potok*) ende nuk janë themeluar. Numri i personave të cilët kanë kërkuar ndihmë juridike falas në këto zyra është 1803.

3.4 Mbrojtja e minoriteteve


Për zbatimin e Strategjisë për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, në 17 komuna është themeluar komiteti lokal ndërsa në 15 komuna (*Gjilan, Novobërdë, Mamushë, Kaçanik, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Podujevë, Kllokot, Kamenicë, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Jugore*) nuk është themeluar. Si dhe në 6 komuna (*Hani Eleziti, Partesh, Ranillug, Junik, Dragash dhe Glllogoc*) nuk ka komunitete rom, ashkali dhe egjiptian. Në 12 komuna është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian ndërsa në 20 komuna (*Vushtrri, Malishevë, Ferizaj, Novobërdë, Zubin Potok, Kllokot, Fushë Kosovë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Kaçanik, Shtërpçë, Leposaviq, Skenderaj, Mitrovicë Veriore, Pejë, Gjilan, Zveçan, Suharekë dhe Mamushë*) nuk është hartuar plani. Si dhe në 6 komuna (*Hani Eleziti, Partesh, Ranillug, Junik, Dragash, Glllogoc*) nuk ka rom, ashkali dhe egjiptian.

Gjatë vitit 2020, numri i personave të regjistruar nga komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian është 5438 në 13 komuna. Për realizimin e fushatave për regjistrim falas të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në 9 komuna janë realizuar fushata për regjistrim, ndërsa në 23 komuna (*Lipjan, Ferizaj, Malishevë, Gjakovë, Suharekë, Novobërdë, Vushtrri, Klinë, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Rabovec, Leposaviq, Graçanicë, Viti, Podujevë, Istog, Fushë Kosovë, Kllokot, Kamenicë, Zubin Potok, Mitrovicë, Gjilan dhe Zveçan*) nuk janë realizuar fushata si dhe 6 komuna (*Hani Eleziti, Partesh, Ranillug, Junik, Dragash dhe Glllogoc*) nuk ka rom, ashkali dhe egjiptian.

Për mbrojtjen e komuniteteve jo shumicë, janë 20 komuna të cilat kanë ndarë buxhet në vlerë prej 461,090.00 euro, gjithashtu komunat kanë ndërmarr aktivitete për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve jo shumicë.

3.5 Drejtësia, liria dhe siguria,

Në fushën e riintegrit raportit i KE-së për Kosovën ka identifikuar si sfida hartimin e Planit lokal të veprimit për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar të cilin plan janë 25 komuna të cilat kanë arrit që të hartojnë këtë plan ndërsa 13 komuna (*Mamushë, Ranillug, Zubin Potok, Zveçan, Prizren, Deçan, Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë, Leposaviq, Graçanicë, Peja, Kllokot, dhe Ferizaj*) ende nuk e kanë hartuar këtë plan, gjithashtu në vitin 2020 është ndarë buxhet për personat e riintegruar vetëm në 4 komuna (*Suharekë, Vushtrri, Graçanicë, Prizren*).



Diagrami 6: Plani Lokal i veprimit për riintegrim e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar

3.6 Menaxhimi i kufirit dhe migracioni

Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur, dhe përkrahja nga niveli lokal ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe. Në 20 komuna numri i personave të zhvendosur është 1985 ndërsa në 18 komuna (*Lipjan, Shtime, Ferizaj, Obiliq, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Hani Elezit, Prishtinë, Partesh, Zveçan, Kamenicë, Kaçanik, Leposaviq, Skenderaj, Junik, Graçanicë dhe Mitrovicë Veriore*) nuk ka pasur persona të zhvendosur. Për këta persona të rikthyer në 13 komuna (*Gjakovë, Obiliq, Novobërdë, Istog, Fushë Kosovë, Prizren, Kamenicë, Deçan, Klinë, Rahovec, Pejë, Shtërpçë dhe Graçanicë*) janë ndërtuar 147 shtëpi.


Sa i përket aplikimit për asistencë nga fondi për ri-integrim në 17 komuna numri i aplikimeve është 318 ndërsa numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesua në 13 komuna është 25. Numri i personave të riatdhesuar të cilët janë pajisur me dokumente personale në 15 komuna është 705.

Gjithashtu janë 28 komuna të cilat kanë theksuar sfidat me të cilat përballen në krijimin e mundësive për jetë për personat e rikthyer si: *buxheti jo i mjaftueshëm për përkrahjen e tyre dhe nevojat e tyre, informimi jo i mjaftueshëm për rrjedhën e kthimit nga niveli qendror, rindërtimi i shtëpive si dhe mos përkrahja nga niveli qendror.*

Sa i përket punës dhe rolit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), Këshillit Lokal për Siguri Publike (KLSP), Ekipit Vepruese për Siguri (EVS) dhe Këshillit të fshatrave një numër i konsiderueshëm i komunave kanë arritur që të themelojnë dhe të funksionalizojnë këto Këshilla dhe Ekiye. Në 35 komuna janë themeluar dhe janë funksionale KKSBB-të ndërsa në 3 komuna (*Novobërdë, Mitrovicë e Veriut dhe Leposaviq*) nuk janë themeluar, prej tyre janë 33 komuna që kanë mbajtur gjithsej 141 takime ndërsa 2 komuna (*Zubin Potok, dhe Zveçan*) nuk kanë mbajtur asnjë takim.

Këshilli Lokal për Siguri Publike është themeluar dhe është funksional në 28 komuna ndërsa në 8 komuna (*Novobërdë, Mamushë, Deçan, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Junik, Shtërpçë, Ranillug*) nuk është funksional si dhe 2 komuna (*Hani Elezit, Mitrovicë Jugore*) nuk kanë ofruar informacione, prej tyre janë 22 komuna që kanë mbajtur gjithsej 82 takime kurse 6 komuna (*Shtime, Zubin Potok, Klinë, Zveçan, Ferizaj, Gjakovë,*) nuk kanë mbajtur asnjë takim.

Ekipi Vepruese për Siguri është funksional në 27 komuna si dhe në 11 komuna (*Novobërdë, Mamushë, Deçan, Klinë, Skenderaj Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë Jugore, Klokot, Ranillug*) nuk është ende funksional, prej tyre janë 14 komuna që kanë mbajtura gjithsej 31 takime ndërsa 13 komuna (*Ferizaj, Shtime, Dragash, Kaçanik, Pejë, Graçanicë, Prizren, Prishtinë, Istog, Gjakovë, Zubin Potok, Partesh, Zveçan*) nuk kanë mbajtur asnjë takim.



Diagrami 7: Funksionalizimi i KKSBB-ve, KLSP-ve dhe EVS-ve

Këshillat e fshatrave janë themeluar dhe janë funksionale në 24 komuna ndërsa në 11 komuna (*Mamushë, Ranillug, Dragash, Klinë, Junik, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Istog, Fushë Kosovë*) nuk janë themeluar. Si dhe në 3 komuna (*Podujevë, Partesh, Prishtinë*) janë themeluar por nuk janë funksional.

3.7 Arsimi dhe kultura


Zhvillimi i sistemit të arsimit dhe ngritja e kapaciteteve në arsimin gjithëpërfshirës kanë vazhduar në komuna, për të cilën fushë 32 komuna kanë vepruar në zhvillimin e avancimit të mësimdhënësve kurse në 6 komuna (*Mamushë, Dragash, Mitrovicë e Veriut, Skenderaj, Kaçanik, Partesh*) nuk ka pasur veprime të ndërmarra. Për rekrutimin e stafit në arsimin para fillorë, fillor dhe të mesëm janë 35 komuna të cilat kanë deklaruar se këto rekrutime bëhen në mënyrë meritore ndërsa 3 komuna (*Novobërdë, Mitrovicë Veriore, Partesh*) nuk kanë ofruar të dhëna.

Sa i përket rritjes së nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor, në 29 komuna numri i fëmijëve të moshës 0-5 vjeç që ndjekin arsimimin dhe kujdesin e fëmijërisë së hershme është 7502 fëmijë ndërsa në 9 komuna (*Mamushë, Podujevë, Partesh, Mitrovicë Veriore, Obiliq, Novobërdë, Zubin Potok, Kllokot, Zveçan*) nuk ka fëmijë të përfshirë të moshës 0-5 vjeç në çerdhe. Numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët janë përfshirë në çerdhe në 27 komuna është 749 kurse në 11 komuna (*Shtime, Novobërdë, Zubin Potok, Ranillug, Kllokot, Partesh, Zveçan, Dragash, Junik, Graçanicë, Mitrovicë Veriore*) nuk kanë fëmijë me nevoja të veçanta të cilët janë përfshirë në institucionet e arsimit parashkollor. Me qëllim të ndjekjes së këtij edukimi janë 31 komuna që kanë ndërmarr veprime si: *themelimi i ekipit për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta; sigurim i transportit; ndërtimi i çerdheve; plotësimi i stafit profesional; angazhimi i asistentëve për asistimin e fëmijëve me nevoja të veçanta; ofrimi i kushteve infrastrukturore; krijimi i qendrave rurale të KZHFH (Kujdesit dhe Zhvillimit në Fëmijërinë e Hershme, ndërsa 7 komuna (*Ranillug, Zubin Potok, Mitrovicë Veriore, Podujevë, Kllokot, Shtime, Partesh*) nuk kanë ndërmarr ndonjë veprim.*

Në 5 komuna (*Ferizaj, Gjiilan, Vushtrri, Pejë, Prizren*) komuniteti jo shumicë vazhdon të përballet me sfidat kryesisht për shkak të mungesës së librave shkollore, për të cilat raste komunat kanë ngritur shqetësime në institucione përkatëse. Numri i rasteve të braktisjes së shkollimit nga komuniteti jo shumicë në 7 komuna është 121. Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mos regjistrimit të shkollimit për komunitet jo shumicë (rom dhe ashkali) është i hartuar vetëm në 7 komuna (*Gjakovë, Shtime, Obiliq, Pejë, Vushtrri, Fushë Kosovë, Istog*). Janë 25 komuna të cilat kanë formuar ekipet vepruese për parandalimin e braktisjes së nxënësve në shkolla si dhe 13 komuna (*Malishevë, Novobërdë, Ranillug, Dragash, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Junik, Zveçan, Kllokot, Partesh, Zubin Potok, Kamenicë*) ende nuk i kanë formuar.

3.8 Mjedisi

Komunat mbeten të përkushtuara në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në sistemin e menaxhimit të mbeturinave. Me qëllim të zbatimit Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, 32 komuna kanë hartuar planin për menaxhimin e mbeturinave komunale ndërsa 6 komuna (*Shtërpçë, Dragash, Mitrovicë e Veriut, Malishevë, Zveçan, Zubin Potok*) ende nuk kanë hartuar këtë plan. Sfidat në të cilat hasin komunat në vazhdimësi në zbatimin Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe zbatimin e Planit të menaxhimit të mbeturinave komunale janë: *fondet e pamjaftueshme, vetëdijësimi i qytetarëve, mungesa e pagesave nga ana e qytetarëve, numri i vogël i inspektimeve, mungesa e ndërmarrjeve etj.*



Diagrami 8: Plani për menaxhimin e mbeturinave

Me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së mjedisit, në 20 komuna janë zhvilluar 99 fushata ndërsa 18 komuna (*Ferizaj, Novobërdë, Subarekë, Vushtrri, Malishevë, Hani Elezit, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Partesh, Deçan, Dragash, Kaçanik, Klinë, Leposaviq, Shtërpçë, Junik, Mitrovicë Veriore*) nuk kanë zhvilluar asnjë fushatë.

Inventarin për mbeturina të rrezikshme është përgatitur vetëm në 1 komunë (*Istog*) ndërsa në 36 komuna tjera nuk është përgatitur. Gjithashtu hartimi i planit të veprimit për cilësinë e ajrit mbetet sfida e theksuar e komunave ku vetëm 1 komuna (*Glllogoc*) ka hartuar këtë plan. Numri i deponive ilegale në 34 komuna është 1267 ndërsa në 4 komuna (*Partesh, Junik, Graçanicë, Mitrovicë Veriore*) nuk ka deponi ilegale.

3.9 Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik

Në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës 13 komuna kanë organizuar trajnime për shëndetin e nënës dhe fëmijës ndërsa në 25 komuna (*Gjilan, Novobërdë, Zubin Potok, Deçan, Dragash, Klinë, Pejë, Glllogoc, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Podujevë, Partesh, Fushë Kosovë, Klllokot, Zveçan, Lipjan, Ferizaj, Malishevë, Gjakovë, Shtime, Mamushë, Ranillug*) nuk kanë organizuar asnjë trajnim.

Ndërsa në fushën e shëndetit publik konkretisht në zbatimin e ligjit kundër duhanit në 20 komuna janë bërë 2208 inspektime derisa në 18 komuna (*Gjakovë, Ferizaj, Novobërdë, Zubin Potok, Subarekë, Vushtrri, Mamushë, Gjilan, Fushë Kosovë, Prishtinë, Partesh, Zveçan, Kaçanik, Leposaviq, Pejë, Shtërpçë, Graçanicë, Mitrovicë Veriore*) nuk ka pasur inspektime. Kurse numri i gjobave të shqiptuara në 12 komuna është 987 ndërkaq në 26 komuna (*Gjakovë, Ferizaj, Obiliq, Ranillug, Zubin Potok, Subarekë, Vushtrri, Mamushë, Gjilan, Fushë Kosovë, Prishtinë, Podujevë, Klllokot, Partesh, Zveçan, Deçan, Glllogoc, Dragash, Kaçanik, Leposaviq, Rabovec, Pejë, Shtërpçë, Junik, Graçanicë, Mitrovicë Veriore*) nuk janë shqiptuar asnjë gjobë.

4 VEPRIMET E NDËRMARRA NGA KOMUNAT ME RASTIN E COVID -19

Masat e ndërmarrë nga Qeveria kundër pandemisë COVID-19 si dhe rekomandimet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës në vazhdimësi janë zbatuar nga komunat. Lidhur me këtë, në 27 komuna janë shqiptuar 5435 gjoba ndërsa në 11 komuna (*Gjakovë, Lipjan, Ferizaj, Ranillug, Podujevë, Viti, Partesh, Zveçan, Mitrovicë, Rahovec, Graçanicë*) nuk është shqiptuar asnjë gjobë pasi që janë respektuar masat e rekomanduara.

Përveç respektimit të masave dhe shqiptimit të gjobave komunat gjithashtu kanë ndërmarr një numër të madh të veprimeve për parandalimin e pandemisë COVID-19 ku 37 komuna: *janë themeluar shtabet emergjente komunale, janë bërë dezinfektimet e gjitha objekteve, janë bërë instalimet e tuneleve dezinfektuese, janë zbatuar masat dhe rekomandimet nga MSH, është ofruar përkujdesje shëndetësore ndaj personave të prekur me COVID 19, është ofruar ndihmë për familjet me nevoja, është bërë aktivizimi i administratorëve të fshatrave, janë ngritur tenda për kontrollë paraprakë për personat me simptomat e virusit pandemik, është ofruar kontributë në kompanitë publike me pajisje për mbrojtje nga virus, është zhvilluar një sërë ligjëratah online me mjek të lëmive të ndryshme, pediatër, teolog, etj* ndërsa 1 komuna (*Zveçan*) nuk kanë ofruar të dhëna.

Sa i përket ndarjes së mjeteve për menaxhimin e pandemisë, nga 38 komuna gjithsej 33 prej tyre kanë ndarë mjete financiare për menaxhimin e pandemisë së COVID – 19 në vlerë prej 8,018,484.98 euro. Ndërsa, 2 komunat (*Novobërdë, Kllokot*) nuk kanë ndarë mjete si dhe 3 komuna (*Graçanicë, Zveçan, Partesh*) nuk kanë ofruar të dhëna.

Mirëpo sfida me të cilat përballen 33 komuna gjatë parandalimit të pandemisë janë: *resurset humane jo të mjaftueshme, mungesë e mjeteve mbrojtëse, numri i vogël i testimave, stafi i kufizuar mjekësor, mungesë e mjeteve financiare* etj ndërsa në 4 komuna (*Novobërdë, Mamushë, Ranillug, Podujevë*) nuk kanë pasur ndonjë sfidë si dhe 1 komuna (*Zveçan*) nuk kanë ofruar të dhëna. Për shkak të pandemisë COVID-19 janë mbyllur 592 biznese në 21 komuna.

REKOMANDIMET:

Në bazë të dhënave të nxjerra nga raportet individuale të komunave në këtë raport, MPL rekomandon:

- **Të hartohet Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun në komunat:** Obiliq, Shtime, Ferizaj, Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Kllokot, Kamenicë, Prizren, Viti, Mitrovicë, Prishtinë, Dragash, Glllogoc, Mitrovicë Veriore, Kaçanik, Leposaviq, Fushë Kosovë, Gjilan, Lipjan, Junik, Shtërpcë;
- **Të hartohet Strategjia kundër dhunës në familje:** Malishevë, Ferizaj, Shtime, Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Prizren, Prishtina, Podujeva, Partesh, Deçan, Klinë, Kaçanik, Rahovec, Glllogoc, Shtërpcë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Junik, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Gjilan, Peja, Fushë Kosovë, Kllokot, Hani Elezit, Zveçan;
- **Të hartohet Plani Lokal për Integritet në komunat:** Obiliq, Ferizaj, Shtime, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Kllokot, Kamenicë, Zveçan, Hani Elezit, Prizren, Mitrovicë Jugore, Deçan, Dragash, Klinë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Shtërpcë;
- **Të hartohet Plani tre-vjeçar për strehim Social në komunat:** Malishevë, Novobërdë, Vushtrri, Mamushë, Obiliq, Dragash, Klinë, Kaçanik, Junik, Rahovec, Shtërpcë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Prishtinë, Viti, Mitrovicë Jugore, Istog, Kllokot, Zveçan, Kamenicë, Hani i Elezit, Ranillug, Zubin Potok, Partesh;
- **Të hartohet Plani për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në komunat:** Gjakovë, Gjilan, Shtime, Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Suharekë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Istog, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Prishtinë, Podujevë, Kllokot, Viti, Partesh, Zveçan, Kamenicë, Mitrovicë, Deçan, Glllogoc, Dragash, Klinë, Leposaviq, Pejë, Shtërpcë, Junik, Graçanicë, Mitrovicë Veriore;
- **Të hartohet Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në komunat:** Gjakovë, Gjilan, Shtime, Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Suharekë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Istog, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Prizren, Kllokot, Viti, Partesh, Zveçan, Mitrovicë, Deçan, Dragash, Kaçanik, Klinë, Leposaviq, Rahovec, Pejë, Skenderaj, Shtërpcë, Graçanicë, Mitrovicë Veriore;
- **Të hartohet Plani për Eficiençës të Energjisë në komunat:** Vushtrri, Malishevë, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq;
- **Të hartohet Plani Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në komunat:** Mamushë, Ranillug, Zubin Potok, Zveçan, Prizren, Deçan, Mitrovicë e Veriut, Shtërpcë, Leposaviq, Graçanicë, Peja, Kllokot, Ferizaj;
- **Të hartohet plani për menaxhimin e mbeturinave në komunat:** Shtërpcë, Dragash, Mitrovicë e Veriut, Malishevë, Zveçan, Zubin Potok;
- **Të miratohet Planin për Menaxhimin e tokave rurale në komunat:** Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Suharekë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Istog, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Kllokot, Viti, Partesh, Zveçan, Kamenicë, Mitrovicë, Deçan, Glllogoc, Dragash, Kaçanik, Klinë, Leposaviq, Rahovec, Pejë, Skenderaj, Shtërpcë, Junik, Graçanicë, Mitrovicë Veriore;
- **Të hartohet Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunat:** Vushtrri, Malishevë, Ferizaj, Novobërdë, Zubin Potok, Kllokot, Fushë Kosovë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Kaçanik, Shtërpcë, Leposaviq, Skenderaj, Mitrovicë Veriore, Pejë, Gjilan, Zveçan, Suharekë, Mamushë;
- **Të hartohet plani i veprimit për cilësinë e ajrit në komunat:** Gjakovë, Gjilan, Lipjan, Shtime, Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Suharekë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Istog,

Fushë Kosovë, Hani Elezit, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Klllokot, Viti, Partesh, Zveçan, Kamenicë, Deçan, Dragash, Kaçanik, Klinë, Leposaviq, Rahovec, Pejë, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë Jugore, Junik, Graçanicë, Mitrovicë Veriore;

- **Të themelohen dhe të funksionalizohen Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në komunat:** Novobërdë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq;
- **Të themelohen dhe të funksionalizohen Këshillat Lokal për Siguri Publike (KLSP) në komunat:** Novobërdë, Mamushë, Deçan, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Junik, Shtërpçë, Ranillug ndërsa komuna Hani Elezit dhe Mitrovicë Jugore të ofroj informacion;
- **Të themelohet dhe të funksionalizohet Ekipi Vepruese për Siguri (EVS) në komunat:** Novobërdë, Mamushë, Deçan, Klinë, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë Jugore, Klllokot, Ranillug;
- **Të themelohen Këshillat në Fshatra në komunat:** Mamushë, Ranillug, Dragash, Klinë, Junik, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Istog, Fushë Kosovë;
- **Të caktohet zyrtari për mbrojtjen nga diskriminimi në komunat:** Mamushë, Deçan, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Podujevë, Istog;
- **Të caktohet zyrtari që raporton për planin për integritet në komunat:** Malishevë, Suharekë, Novobërdë, Obiliq, Ranillug, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Graçanicë, Junik, Prizren, Viti, Podujevë, Mitrovicë Jugore, Klllokot, Fushë Kosovë, Kamenicë, Prishtinë;
- **Të caktohet zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës:** Malishevë, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Rahovec, Glllogoc, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Novobërdë, Prizren, Istog, Zveçan, Fushë Kosovë, Obiliq, Zubin Potok, Podujevës, Klllokot;
- **Të themelohen Qendra për regjistrimin e bizneseve (one-stop shopet) në komunat:** Mamushë, Zubin Potok, Klllokot, Zveçan, Prishtinë, Partesh, Junik;
- **Të ndahen mjetet financiare për menaxhimin e pandemisë në komunat:** Novobërdë dhe Klllokot si dhe të ofrohen të dhëna nga 3 komunat: Graçanicë, Zveçan, Partesh për mjetet e ndara financiare